

❖ PERSHKRIM I SHKURTER I KOMPANISE

Gener 2 është një nga kompanitë më të mëdha private të ndërtimit dhe zhvillimit të infrastrukturës në Shqipëri. Portofoli i Gener 2 është i diversifikuar në zhvillimin e industrive të tilla si: ndërtim, infrastrukturë dhe menaxhim projektsh inxhinierike, energji dhe telekomunikacion, menaxhim pronash, pasuri të paluajtshme dhe media. Gjatë 20 viteve të fundit, Gener 2, ka lënë gjurmë në tregun shqiptar dhe atë rajonal duke zhvilluar projekte strategjike me standartet më të larta ndërkombëtare e njëkohësisht duke kontribuar në mënyrë domethënëse në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

❖ TITULLI I POZICIONIT TE PUNES

Specialist/e Marketingu

❖ DETYRAT KRYESORE

- Krijimi dhe menaxhimi i fushatave të marketingut në platformat dixhitale
- Menaxhimi i krijimit dhe shpërndarjes së përmbajtjes në kanale të ndryshme komunikimi
- Analizimi i të dhënave dhe matja e performancës së fushatave për të optimizuar rezultatet dhe për të përmirësuar strategjitë.
- Koordinimi i aktiviteteve të marketingut me ekipet e tjera të departamentit dhe palët e jashtme si agjencitë ose partnerët.
- Krijimi i materialeve marketingu (grafika, video, kopje për reklama, etj.) për të mbështetur fushatat.
- Monitorimi i trendëve të industrisë dhe konkurrencës për të ofruar rekomandime për përmirësimin e aktiviteteve të marketingut.
- Sigurimi që të gjitha aktivitetet marketingu të jenë në përputhje me identitetin e qendres.
- Kontribues ne dhenien e ideve per fushatat e marektingut dhe te eventeve
- Ndjekja e eventeve dhe aktiviteteve te marketingut.
- Ndjekja e fushatave online dhe print.

❖ KRITERET KRYESORE

- Diplomë në Marketing, Biznes ose një fushë të ngjashme.
- Të ketë mbi 2 vite eksperiencë në marketing.
- Njohuri te avancuara ne platfomat e mediave sociale
- Aftësi të shkëlqyera analitike dhe aftësi për analizën e të dhënave.
- Aftësi të forta komunikimi.
- Aftësi në shkrim dhe redaktim të përmbajtjes me vëmendje në detaje.
- Aftësi të forta për prioritizimin, organizimin dhe menaxhimin e projektit.
- Njohës i mirë i gjuhës Angleze.

Te gjithë te interesuarit, jane te lutur qe te dergojne CV nepermjet adreses se e-mailit careers@gener2.al ose te plotesojne formularin e aplikimit ne faqen zyrtare www.gener2.al ne seksionin “apliko online”.

Afati i fundit i aplikimit eshte **data 20 Dhjetor 2024, ora 17:00**.

* Vetem kandidatet e perzgjedhur do te kontaktohen.

* Të gjithë aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet sipas ligjit Nr. 9887 mbi “Mbrotjtjen e të dhënave personale”.